**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



## V. PLANI VJETOR I SHKOLLËS

Prioriteti 3 : _____								
Fusha e cilësisë	Plani I aktiviteteve I kopjuar nga tabela 5.1	Rezultatet e pritshme	Progresi <sup>15</sup>			Evidenca e të arriturave e kopjuar nga tabela 5.1	Vështirësitë	Veprimet e ndërmarra
			A	B	C			
		Kjo fushe diskutohet, vlerësohet dhe plotësohet ne periudhën e pare raportuese pas fillimit te zbatimit te këtij plani						

*E kryer nga drejtorët e shkollës, mbështetur nga koordinorët e cilësisë, raportohet tek bordi Drejtues i Shkollës*

<sup>15</sup> Referohet vlerësimit të progresit në krahasim me (A) E implementuar plotësisht në kohë, rezultatet janë arritë; (B) Është vonuar, rezultatet janë implementuar pjesërisht; (C) Nuk është implementuar, aktivitetet janë anuluar apo janë në rrezik për tu anuluar.



**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



## V. PLANI VJETOR I SHKOLLËS

### 5.3. Aktivitete tjera

Në këtë seksion, shkolla nxjerr në pah ndonjë aktivitet të paplanifikuar apo adhoc që ka ndodhur gjatë vitit aktual. Këto mund të jenë aktivitete të reja si rezultat i donacioneve të reja, ide të reja apo mundësi të reja të krijuara me iniciativë të rjeteve të shkollave.

7770???



**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



## SHTOJCA

### 1. Të dhënat bazë të SMIA-s

(Përdoret formati në përdorim nga shkollat – për nevojat e shkollës dhe DKA )

Nr.	Emri i shkollës	Lok. i shk. Urban/Rural	Nr. i ndrrimeve	Nr. i nxënësve			Personel		
				Meshkuj	Femra	Gjithsej	Mësimdhënës	Admin.	Ndihmës.
	"Dardania"	Urban	2	1056	993	2049	18	67	85

#### GJENDJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE -SHKOLLAT FILLORE 2021-22

##### Shkolla "Dardania

##### Sasia

Gjithsej nr. i dhomave	34
Nr. i mësonjëtove	34
Nr. i dhomave për nevoja të veçanta	0
Kabinete	12
Nr. i dhomave për parafillor	3
Nr. i dhomave për mësimdhënës	1
Nr. i dhomave për admin.	5
Nr. i toaleteve-meshkuj	14
Nr. i toaleteve -femra	14
Nr. i toaleteve -për të hendikepuar	1
Nr. i toaleteve -mësimdhënës	4
Nr. i punëtorive	2
Hapsirë e objektit shkollor./ M2	4.5
Dhoma e muzikës	0
Hapsira e korridorit në M2	2200
Biblioteka:	po



**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



Kuzhina	1
Salla e gjimnastikës	1
Depoja	2
Hapsira e oborrit të shkollës në M2	1890
Furnizimi i ujit	I mire
Drenazha	po
Ngrohja	e mire
Fushe e sportit	po





**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



## SHTOJCA

### 2. Përmbledhje e raportit të vetëvlerësimit të performancës së shkollës

Udhëzimet dhe sqarimet e detajuara për përdorim të kësaj tablele janë dhënë në Modulin III – Plani Zhvillimor i Shkollës.

Vlerësimi i fushës së cilësisë		
Fusha e cilësisë: MENAXHIMI DHE QEVERISJA [A]		
Përshkrim i performancës së shkollës	Dëshmitë/evidencat	Komente shtesë
<b>Shkëlqyeshëm</b>	Procesverbalet e mbledhjeve, rezultatet nga pyetësorët e ndryshëm, fotografi të proceseve, projektet e fituara, certifikata të përfundimit të programeve për qeverisje.	Ne kemi përfunduar procesin e vlerësimit të performancës së brendshme të shkollës me ekipin për VB

Vlerësimi i fushës së cilësisë		
Fusha e cilësisë: KULTURA DHE MJEDISI SHKOLLOR [B]		
Përshkrim i performancës së shkollës	Dëshmitë/evidencat	Komente shtesë
<b>Shkëlqyeshëm</b>	Procesverbalet e mbledhjeve, rezultatet nga pyetësorët e ndryshëm, fotografi të proceseve, projektet e fituara.	Për të gjitha dëshmitë ekziston prezantimi i Inspektoreve të arsimit të përzgjedhur nga MASHT për vlerësimin e performancës sonë.

Vlerësimi i fushës së cilësisë		
Fusha e cilësisë: MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA [C]		
Përshkrim i performancës së shkollës	Dëshmitë/evidencat	Komente shtesë
<b>Mirë</b>	Procesverbalet e mbledhjeve, rezultatet nga pyetësorët e ndryshëm, fotografi të proceseve, projektet e fituara, certifikata të përfundimit të programeve për qeverisje, licencat, certifikatat e trajnimeve, mirënjohjet, etj..	Për të gjitha dëshmitë ekziston prezantimi i Inspektoreve të arsimit të përzgjedhur nga MASHT për vlerësimin e performancës sonë.

E kryer nga koordinatori i cilësisë në diskutim me Aktivat profesionale dhe Këshillin e nxënësve



**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



## SHTOJCA



Vlerësimi i fushës së cilësisë		
Fusha e cilësisë: MENAXHIMI DHE QEVERISJA [D]		
Përshkrim i performancës së shkollës	Dëshmitë/evidencat	Komente shtesë
Zhvillimi profesional i mësimit dhe mësuesve  <b>Mirë</b>	Procesverbalet e mbledhjeve, rezultatet nga pyetësorët e ndryshëm, fotografi të proceseve, projektet e fituara, certifikata të përfundimit të programeve për qeverisje, licencat, certifikatat e trajnimeve, mirënjohjet, etj..	Për të gjitha dëshmitë ekziston prezantimi i Inspektoreve të arsimit të përzgjedhur nga MASHT për vlerësimin e performancës sonë.

Vlerësimi i fushës së cilësisë		
Fusha e cilësisë: KULTURA DHE MJEDISI SHKOLLOR [E]		
Përshkrim i performancës së shkollës	Dëshmitë/evidencat	Komente shtesë
Performanca e nxënësve.  <b>Mirë</b>	Procesverbalet e mbledhjeve, rezultatet nga pyetësorët e ndryshëm, fotografi të proceseve, projektet e fituara, certifikata të përfundimit të programeve për qeverisje etj.	Për të gjitha dëshmitë ekziston prezantimi i Inspektoreve të arsimit të përzgjedhur nga MASHT për vlerësimin e performancës sonë.

### NIVELI I PËRGJITHSHËM I PERFORMANCËS SË SHKOLLËS

Niveli:

Përshkrimi i performancës së përgjithshme	Përparësitë dhe dobësitë e identifikuar	Rekomandime
Ekipi i vlerësimit të performancës së shkollës, harton këtë raport, i cili ka për qëllim të bëjë përshkrimin e performancës së shkollës. Ky raport është i përgatitur në harmoni të plotë me parimet e kurrikulës (gjithëpërfshirja, zhvillimi i kompetencave, mësimit dhe nxënësve të integruar, autonomia dhe fleksibiliteti, përgjegjësi dhe llogaridhënia) si dhe me gjendjen aktuale në shkollë. Përshkrimet në raport gjithmonë janë të mbështetura me fakte të cilat i kemi ofruar me anën e vëzhgimit, intervistave, pyetësorëve (për prindër, mësimit dhe nxënës), takimeve me	Përparësitë Vlerësim të brendshëm me klasa të V-ta dhe të IX-ta për të siguruar analizën e gjendjes së shkollës.  Menaxhmenti vazhdimisht mbikëqyr suksesin e nxënësve dhe në bazë të rezultateve të testeve e raporteve planifikon për përmirësimin e këtyre rezultateve.  Përkrahje të vazhdueshme nga udhëheqësi i shkollës përkrah aktiveve të klasave, profesionale, grupet letrare, muzikore, klubi i gjelbërt, të cilat angazhohen dhe përkrahin në mënyrë	Dimensioni 1  Rekomandimet për dimensionin Menaxhimi dhe udhëheqja:  - Promovimin misionit dhe vizionit të shkollës në komunitet (publikimi i një buletini vjetor, elektronik apo të shtypur për komunitetin);  - Rritja e bashkëpunimit në drejtim të mësimit dhe integruar (realizimi i një punëtorie) për hartim dhe zbatim të



**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



<p>mësimdhënës, nxënës dhe prindër, dokumentet e ndryshme raporte, procesverbale, procesverbali i KDSH-së, ditarët, planifikimet e mësimdhënësve, kutia e ankesave, PZSHH-s, psikologjen e shkollës etj.</p> <p>Prioriteti i udhëheqësisë është gjithëpërfshirja e akterëve relevantë, bashkëpunimi me të gjitha palët e interesit, me qëllim të jetësimit të vizionit të shkollës. Shkolla ka mekanizma relativisht efektiv të komunikimit dhe konsultimit me prindër si dhe mekanizma të llogaridhënies. Udhëheqësia e shkollës menaxhon procesin e punës në shkollë dhe në mënyrë sistematike përcjell realizimin e prioriteteve të përcaktuara në PZSHH. Për ngritjen e përgjegjesisë dhe llogaridhënies, si dhe zbatimit të rregulloreve të hartuara nga MASH, DKA dhe shkolla, këshilli drejtues i shkollës dhe udhëheqësia e shkollës kanë propozuar dhe aprovuar formimin e komisionit për ndërmjetësim dhe komisionit disiplinor të cilët do të merren dhe trajtojnë çështjet që kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe llogaridhënien, si dhe kanë të drejtë të përpilojnë raport për personat të cilët nuk i respektojnë rregullat. Me qëllim të respektimit të mësimdhënësve dhe ruajtjes së autoritetit të tyre KDSH dhe këshilli i arsimtarëve në rast të mosrespektimit të rregulloreve në fuqi, së pari merret grupi për ndërmjetësim i cili e luan rolin e një këshillëdhënësi dhe ka për qëllim që problemi të zgjidhet para se të shkojë në komisionin disiplinor. Menaxhmenti vazhdimisht mbikëqyr suksesin e nxënësve në bazë të rezultateve të testeve, raporteve (tremujore, gjysmëvjetore, vjetore, të arritshmërisë) dhe planifikon marrjen e masave për përmirësimin e dhe ngritjen e rezultateve.</p> <p>Kultura organizative që ofrohet nga shkolla mundëson krijimin e një mjedisi të përshtatshëm e të sigurt për punë si dhe për një bashkëpunim të gjerë ndërmjet mësimdhënësve, prindërve, nxënësve dhe komunitetit, duke përkrahur lirinë e shprehjes për të gjithë respektimin e diversitetit kulturor, fetar, racor dhe iniciativat e ndryshme që janë në të mirën e të gjithëve. Menaxhmenti i shkollës, mësimdhënësit dhe nxënësit janë të përgjegjshëm për ruajtjen e ambientit, objektit, pajisjeve, dhe respektimin e rregulloreve të hartuara</p>	<p>direkte dhe indirekte projektet që ofrohen nga nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit në lëndë të ndryshme.</p> <p>Infrastruktura e përshtatshme në mabientin që mundëson zhvillimin e aktiviteteve dhe punës praktike në shumë lëndë.</p> <p>Kultura organizative në shkollë është e dizajnuar në atë mënyrë që të gjithë marrin detyrat dhe japin llogari për përmbushjen e detyrave.</p> <p>Mundësia e shfrytëzimit të të gjitha burimeve dhe mjeteve që posedon shkolla nga ana e nxënësve, njëkohësisht ata janë të përgjegjshëm në shfrytëzimin e kësaj të drejte, por edhe kontribues efektiv në një mjedis më atraktiv.</p> <p>Planprogramet lëndore hartohen dhe rishikohen në bashkëpunim me aktivet profesionale</p> <p>Shkolla mbledh të dhëna (kutia e ankesave) nga nxënësit, prindërit dhe komuniteti lidhur me këndvështrimet e tyre për mbarëvajtjen e procesit mësimor që ofron shkolla dhe disa kërkesa i integron në planin e përmirësimit të proceseve mësimore në shkollë.</p> <p>Integrimi i prindërve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm në procesin mësimor.</p> <p>Ngritja profesionale e mësimdhënësve.</p> <p>Komunikimi shkollë-familje.</p> <p>Përdorimin e strategjive të llojllojshme për zotërimin e kompetencave kryesore.</p> <p>Përgatitja profesionale e mësimdhënësve.</p> <p>Ndjekja e procedurave për përzgjedhjen e Mësimiit zgjedhor.</p> <p>Vlerësimi i vazhdueshëm i performancës së mësimdhënësve nga drejtoria e shkollës.</p> <p>Dobësitë:</p> <p>Vlen të ceket që gjatë procesit të hartimit të misionit dhe vizionit të shkollës përfshirja e prindërve nuk është në nivelin e duhur.</p> <p>Mundësia e mangët për lëvizjen e</p>	<p>planeve javore);</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Fleksibilitet dhe autonomi në nivel fushave për projekte inovative (projekte në nivel të fushave, një projekt për periode);</li> <li>- Takime periodike (3 mujore), të stafit me karakter raportues, informues dhe motivues për arritje të rezultateve të punës.</li> </ul> <p>Dimensioni 2</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Ndërtimi i pjerrinave për qasje të lirë për fëmijët me nevoja të veçanta;</li> <li>- Pasurimi i dritareve me rolete jotransparente, pasiqë në temperatura të larta procesi mësimor realizohet me vështirësi;</li> <li>-Të bashkëpunohet më shumë me Qendrën për Punë Sociale për nxënësit që shkaktojnë probleme në shkollë;</li> <li>-T'u sigurohen nxënësve bexha dhe uniforma (maica,duksa). Poashtu mësimdhënësit të kenë bexha dhe uniformë të unifikuar;</li> <li>-Hapësira e rreshtit të nxënësve të jetë me një strehë kreative (mbrojtje nga dielli dhe shiu).</li> </ul> <p>Dimensioni 3</p> <p>Për menaxhmentin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Prindërit të jenë më të përfshirë në jetësimin e Kurrikulës me bazë në shkollë.</li> <li>- Të bashkëpunojë ngushtë me DKA dhe prindërit që kanë fëmijë me nevoja të veçanta me qëllim të hartimit të PIA.</li> <li>-Të formohet një ekip inkluziv brenda shkollës.</li> </ul> <p>(hartimi planit PIA për nxënës brenda shkollës).</p> <p>Për prindër:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të bashkëpunojnë ngushtë me mësimdhënësit me qëllim që të arrihen rezultate të dyanshme, të përgjigjen në thirrjet e mësimdhënësve në afatin kohor më të shkurtër.</li> </ul> <p>Dimensioni 4</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Organizimi i trajnimeve të kërkuara nga mësimdhënësit;</li> <li>-Të organizohen mënyra të ndryshme</li> </ul>
---	---	--



**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



<p>nga shkolla.</p> <p>Shkolla ka një sistem relativisht të mirë të punës duke përfshirë në mënyre aktive të gjithë faktorët që lidhen me procesin mësimor dhe duke informuar prindërit për arritshmërinë e fëmijëve të tyre, zhvillimin dhe progresin; por më rrallë i përfshin në procesin e jetësimit të kurrikulës me bazë në shkollë.</p> <p>Metodologjia që praktikojnë mësimit në klasat e tyre kanë për qëllim përkrahjen e nxënësve në punë ekipore, individuale duke i inkurajuar që të hulumtojnë e të njohin vlerat e shoqërisë demokratike të shekullit 21.</p> <p>Rezultatet e vlerësimit për të nxënësit e nxënësve që bëjnë mësimit, ndihmon në organizimin e mësimit plotësues dhe avancues. Menaxhmenti i shkollës përkrah dhe inkurajon mësimit për përcjelljen e ndryshimeve pedagogjike dhe përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave mësimore. Ata vëzhgojnë qasjen e metodologjisë së punës së mësimit dhe për secilin prej tyre përgatiten dosje personale, ku raportohen anët e forta dhe të dobëta të tyre.</p> <p>Faktor kyq për ngritjen e performancës së shkollës është edhe ngritja profesionale e mësimit, për këtë shkolla ka ofruar mundësi të shumta për trajnime të ndryshme duke filluar nga ato me bazë në shkollë si dhe trajnime të tjera, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin profesional të mësimit dhe i cili zhvillim reflekton në ngritjen e cilësisë së mësimit dhe nxënies.</p> <p>Gjithëpërfshirjen në zhvillimin profesional e mundëson databaza e krijuar vetëm për ZHPM, ku ekziston një pasqyrë e qartë se cili nga ta ka nevojë për trajnimin në fjalë. Stafi drejtues mban përgjegjësi dhe angazhohet për trajnimet e mësimit të cilat ndikojnë në ngritjen e performancës së vetë mësimit dhe nivelin e mësimit dhe nxënies.</p> <p>Mësimit synojnë që njohuritë e fituara gjatë trajnimeve t'i përdorin në realizimin e mësimit të integruar.</p> <p>Bashkëpunimi i shkollës me DKA-në, OJQ-të, komunitetin e donatorët e ndryshëm ka për qëllim sigurimin e mundësive për avancim të zhvillimit profesional të mësimit. Kushtet për trajnim në shkollë janë mjaft të mira në aspektin teknik, organizativ, të</p>	<p>nxënësve me aftësi të kufizuara brenda shkollës.</p> <p>Nxënësit nuk janë të pajisur me uniforma.</p> <p>Mësimit nuk janë të trajnuar lidhur me vlerësimin për shkollë.</p> <p>Përfshirja jo e kënaqshme e prindërve në procesin e jetësimit të kurrikulës në shkollë.</p> <p>Nuk është hartuar PIA për të gjithë nxënësit që kanë nevojë, për arsye të ndryshme</p>	<p>të bashkëpunimit në mes të mësimit (mentorimi kolegial).</p> <p>Dimenzioni 5</p> <p>-Funksionalizimi më i mirë i kabineteve (përdorimi më i madh i praktikës).</p>
--	---	---



**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



burimeve njerëzore (mësimdhënësit mentorë, fasilitatorë, trajnerë, koordinatorë, grupet për përkrahje teknike).

Shkolla ofron mundësinë e përfshirjes së nxënësve duke u ofruar një ambient të mirë dhe të sigurt. Nxënësit janë të përfshirë në të gjitha strukturat e shkollës duke filluar nga këshilli drejtues i shkollës, rinia shkollë, grupet e ndryshme punuese (grupi letrar, klubi i gjelbërt, klubi i matematikentëve, fizikentëve, ekipi i futbollit, basketbollit, volejbollit, etj). Në shumicën e këtyre grupeve vazhdimisht punohet duke marrë parasysh idetë si dhe mendimet e shumicës së nxënësve, me qëllim që vazhdimisht të kemi zhvillim të aftësive e shkathtësive të nxënësve (fizike e mendore), në mënyrë që ato të përdoren në situata të ndryshme për arritjen e qëllimeve për zhvillimin dhe avancimin e nxënësve. Në vazhdimësi ekziston përkrahja, ndihma dhe motivimi nga mësimdhënësit e kjo ka treguar një ngritje në mësimdhënie, nxënie që ka ndikuar në ngritjen e performancës së nxënësve dhe ngritjen e performancës së shkollës. Duke ditur se bashkëpunimi në shumë raste ndikon në ngritjen e rezultateve edhe në rastin e mësimdhënies ka rëndësi të madhe, që të kemi një integrim të ngushtë, të aktiveve profesionale dhe atyre të klasëve. Shkolla tregon gatishmëri për bashkëpunim duke informuar nxënësit, mësimdhënësit me rregullat e shkollës, obligimet dhe përgjegjësitë. Nxënësit janë të përfshirë në strukturat që kanë hartuar këto rregulla. Nxënësit e gëzojnë autonominë për të propozuar dhe ndryshuar shumë qështje që janë për të mirën e tyre dhe shkollës. Ata i përdorin të gjitha hapësirat brenda dhe jashtë shkollës si dhe kanë mundësi që ato ti ndryshojnë apo edhe të shtojnë pjesë tjera. Nxënësit janë të përfshirë në një masë edhe në procesin e mësimdhënies duke marr parasysh kërkesat e tyre për kohën e mbajtjes së testeve, mënyrën e realizimit të orëve mësimore, metodat e mësimdhënjes, mënyrën e shfrytëzimit të kabineteve etj. Nxënësit e gëzojnë të drejtën për organizime të ndryshme ku në tërësi ata e planifikojnë atë projekt dhe vetë e realizojnë. Krahas përkushtimit për një përmbajtje brenda parimeve të parapara me kurrikulë rëndësi të madhe po i kushtohet



**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



zhvillimit të përgjegjësisë dhe llogaridhënies duke përgatitur nxënës me vetbesim, vizionarë, të përgjegjshëm dhe që jep llogari për punën e kryer. Shkolla ka organizuar një mësimdhënie të integruar edhe për fëmijët me nevoja të veçanta dhe ka një infrastrukturë deri diku të përshtatshme për këta fëmijë. Me planin PIA punojnë një numër i vogël mësimdhënësish, por për mosrealizim ndikojnë disa faktorë si: puna e ngadalshme e institucioneve përgjegjëse, mospajtimi i prindërve në disa raste etj. Ka ngecje në përgatitjen e hapësirave për lëvizjen e lirë të këtyre fëmijëve ku qasja e tyre në katet e sipërme është e pamundur. Në aspektin financiar vlen të përmendet mosangazhimi i asistenteve nga institucionet që duhet të merren me këtë punë por e tëra mbulohet nga angazhimi dhe financimi i prindërve të tyre. Shkolla krahas ekipeve të ndryshme punuese ka formuar edhe ekipin i cili merret me fëmijët të cilët bëjnë mungesa të paarsyeshme dhe është në bashkëpunim të përherëshëm me menaxhmentin, prindërit dhe mësimdhënësit. Në bazë të analizës së bërë del se performanca e shkollës tonë është e mirë. Në bazë të rekomandimeve të bëra nga EVV shpresojmë që në vazhdim do të përmirësohet edhe në disa pika ku ka mangësi

*E kryer nga koordinatori i cilësisë në diskutim me Aktivat profesionale dhe Këshillin e nxënësve.*





**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



## SHTOJCA

### 3. Përmbledhje e raportit për sigurimin e cilësisë

*(Forma e raportit, modeli, ofrohet në Udhëzuesin për sigurim të cilësisë)*

Koordinatori i cilësisë në shkollë, në bashkëpunim me drejtorin e shkollës, përgatit një raport përmbledhës, për një periudhë trevjeçare, për të prezantuar dhe analizuar aktivitetet e ndërmarra dhe rezultatet e arritura drejt ngritjes së cilësisë në shkollë.

Ekipi i vlerësimit të performancës së shkollës, harton këtë raport, i cili ka për qëllim të bëjë përshkrimin e performancës së shkollës. Ky raport është i përgatitur në harmoni të plotë me parimet e kurrikulës (gjithëpërfshirja, zhvillimi i kompetencave, mësimdhënia dhe nxënia e integruar, autonomia dhe fleksibiliteti, përgjegjësia dhe llogaridhënia) si dhe me gjendjen aktuale në shkollë. Përshkrimet në raport gjithmonë janë të mbështetura në fakte të cilat i kemi ofruar me anë të vëzhgimit, intervistave, pyetësorëve (për prindër, mësimdhënës dhe nxënës), takimeve me mësimdhënës, nxënës dhe prindër, dokumentet e ndryshme, PZSH, data baza e shkollës, Web-faqja e shkollës, procesverbali i Këshillit të Rinisë së Shkollës, raporte, procesverbale, procesverbali i KDSH-së, ditarët, dosje personale, kutia e ankesave, fletorja e konsultimeve me prindër etj.

Shkolla ka filluar punën më 25.03.1985. Pozita e përshtatshme gjeografike dhe infrastruktura e rregulluar bëjnë që kërkesa për të vijuar mësimin në këtë shkollë është shumë e lartë. Personeli i ngritur profesionalisht, kabinetet e pajisura për lëndët përkatëse, fushat sportive, pajisjet kompjuterike, trajnerët me bazë në shkollë, bashkëpunimi me komunitetin janë faktorë për ngritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe nxënie në shkollën tonë. Numri aktual i nxënësve është 2091. Numri i nxënësve që kanë ndërruar shkollën dhe janë shpërngulur në vende të tjera është 17 . Numri i nxënësve të riatdhesuar 0. Braktisje të shkollës nga nxënësit nuk ka. Sa i përket etnitetit është një përqindje e vogël e nxënësve të etnitetit jo shqiptar. Në shkollën tonë ka tri klasë me nga dy grupe parafillorë, kërkesat janë shumë të larta mirëpo shkolla nuk ka kapacitet për pranimin e më shumë nxënësve. Objekti ka 12 kthina ku janë të vendosura mjetet e konkretizimit dhe kabineti i informatikës, i cili është i pajisur me të gjitha mjetet teknologjike. Mënyra e ngrohjes qendrore është funksionale ne te gjithë shkollën. Administrata e shkollës përbëhet nga drejtori, zëvendës drejtori, koordinatorja, sekretarja, psikologu dhe bibliotekistja. Shkolla ka 86 mësimdhënës, prej tyre 69 femra e 17 meshkuj. Kualifikimet e tyre jane: 5 me SHLP, 60 me fakultet, 15 me master të përfunduar dhe 6 jane duke e vijuar masterin..

Mjedisi shkollor

Bashkëpunimi në nivelin e duhur ndërmjet menaxhmentit, mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve; mësimdhënësve ndërmjet veti dhe mësimdhënësve me nxënës, bëjnë një ambient të përshtatshëm për ngritje të mësimdhënies dhe nxënies. Edhe në aspektin teknik shkolla ka një infrastrukturë të mirë dhe që mirëmbahet në mënyrë të shkëlqyeshme (mirëmbajtja e gjelbërimit, këndeve të ndryshme, punimeve në mure të shkollës dhe jashtë saj).

Vlerësimi i performancës për fushën e parë-Menaxhimi dhe Udhëheqja

Prioriteti i udhëheqësisë është gjithëpërfshirja e akterëve relevant, bashkëpunimi me të gjitha palët e interesit, me qëllim të jetësimit të vizionit të shkollës. Shkolla ka bashkëpunim të mirë dhe efektiv me mësimdhënës dhe nxënës mirëpo bashkëpunimi me prindër nuk është gjithmonë efektiv. Udhëheqësia e shkollës menaxhon procesin e punës në shkollë dhe në mënyrë sistematike përcjell realizimin e prioriteteve të përcaktuara në PZSH. Për ngritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies, si dhe zbatimin të rregulloreve të hartuara nga MASHT, DKA dhe shkollë, Këshilli Drejtues i shkollës dhe udhëheqësia e shkollës kanë propozuar dhe aprovuar formimin e komisionit për ndërmjetësim dhe komisionit disiplinor të cilët do të merren dhe trajtojnë çështjet që kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe llogaridhënien, si dhe kanë të drejtë të përpilojnë raport për personat të cilët nuk i respektojnë rregullat. Në rast të mosrespektimit të rregulloreve në fuqi, me qëllim të respektimit dhe



**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



ruajtjes

së autoritetit të mësimdhënësve, KDSH dhe këshilli i arsimtarëve angazhon grupin për ndërmjetësim i cili e luan rolin e një këshillëdhënësi dhe ka për qëllim që problemi të zgjidhet para se të shkojë në komisionin disiplinor. Menaxhmenti vazhdimisht mbikëqyr suksesin e nxënësve dhe në bazë të rezultateve të testeve, raporteve (tremujore, gjysmëvjetore, vjetore dhe të pritishtë) planifikon marrjen e masave për përmirësimin dhe ngritjen e rezultateve. Udhëheqësia e shkollës përkrah aktivitetet e klasave, aktivitetet profesionale, grupet letrare, muzikore, klubin e gjelbërt, të cilat angazhohen dhe ndihmojnë në mënyrë direkte dhe indirekte projektet që ofrohen nga nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit në lëndë të ndryshme. Udhëheqja e shkollës monitoron procesin e punës në shkollë dhe në mënyrë të vazhdueshme bën plotësimin e dokumentacionit, plotësimin e të dhënave në programin SMIA.

Në bazë të këtyre del se performanca është e mirë.

Vlerësimi i performancës për fushën e dytë - Kultura dhe mjedisi shkollor

Kultura organizative që ofrohet nga shkolla mundëson krijimin e një mjedisi të përshtatshëm, të sigurt e të shëndetshëm për punë si dhe për një bashkëpunim të gjerë ndërmjet mësimdhënësve, prindërve, nxënësve dhe komunitetit, duke përkrahur lirinë e shprehjes për të gjithë, respektimin e diversitetit kulturor, fetar, racor dhe iniciativat e ndryshme që janë në të mirën e të gjithëve. Menaxhmenti i shkollës, mësimdhënësit dhe nxënësit janë të përgjegjshëm për ruajtjen e ambientit, objektit, pajisjeve dhe respektimin e rregulloreve të hartuara nga shkolla. Shkolla identifikon nevojat e nxënësve dhe maksimalisht përkushtohet për zhvillimin e secilit në mënyrë individuale dhe grupore, ku përveç ofrimit të mjeteve të konkretizimit riplanifikon shfrytëzimin e hapësirave në shkollë për të mirën e nxënësve, mësimdhënësve, për zbatimin e teorisë në praktikë.

Mjedisit të mirë në shkollë i kontribuon përpilimi i orareve ku planifikohen mbajtja e mësimin shtues, plotësues, mësimin në kabinete, shfrytëzimi i këndeve të ndryshme, klasës verore, ndarja e hapësirave për shfrytëzim të aktiveve të caktuara. Rrjedhimisht, mjedisi fizik dhe kushtet higjienike kanë rezultuar të jenë në nivelin e duhur, si dhe shkolla ka nivel të kulturës dhe mjedis mbështetës. Klimës pozitive në shkollë i kontribuon edhe komuniteti, me pjesëmarrjen e tij në orë mësimore si dhe në aktivitete të ndryshme.

Përformancë e shkëlqyeshme

Vlerësimi i performancës për fushën e tretë- Mësimdhënia dhe nxënia

Shkolla ka një sistem të mirë të punës duke përfshirë në mënyrë aktive të gjithë faktorët që lidhen me procesin mësimor dhe duke informuar prindërit për arritshmërinë, zhvillimin dhe progresin e fëmijëve të tyre, përmes mbledhjeve të rregullta me prindër, konsultimeve individuale javore, telefonit, webfaqes së shkollës.

Metodologjia e punës që praktikojnë mësimdhënësit në klasët e tyre ka për qëllim përkrahjen e nxënësve në punë ekipore, individuale duke i inkurajuar që të hulumtojnë e të njohin vlerat e shoqërisë demokratike të shekullit 21. Rezultatet e vlerësimit, reflektimi i mësimdhënësve për efektivitetin e të nxënësve si dhe informatat kthyesë mes nxënësve dhe mësimdhënësve, ndihmojnë në organizimin e mësimin plotësues dhe avancues.

TIK është pjesë e pandashme e punës në shkollë si në aspektin e mësimdhënies, nxënies edhe për informim të nxënësve, menaxhmentit, kolegëve, prindërve dhe komunitetit.

Planet dhe programet mësimore përgatiten në mënyrë sistematike, me kohe duke u mbështetur në planprogramet me të cilat punojmë.

Bashkëpunimi kolegjial është për çdo lëndë, të gjithë mësimdhënësit angazhohen në mënyrë aktive për përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe të nxënësve. Ata bëjnë planifikim të detajuar rreth datave të mbajtjes së testeve në mënyrë që të shmangin mbajtjen e dy ose më shumë testeve brenda një dite. Mësimdhënësit vazhdimisht raportojnë për të nxënësve dhe bashkëpunojnë me prindër për t'i mbështetur dhe inkurajuar ata.

Menaxhmenti i shkollës përkrah dhe inkurajon mësimdhënësit për përcjelljen e ndryshimeve pedagogjike dhe përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave mësimore. Ata vëzhgojnë qasjen e metodologjisë së punës së mësimdhënësve dhe për secilin prej tyre përgatiten dosje personale, ku raportohen anët e forta dhe të dobëta të tyre. Shkolla në mënyrë sistematike mbledh të dhëna nga faktorët kyç të procesit mësimor si: nga nxënësit, prindërit dhe komuniteti për përmbajtjen dhe zhvillimin e procesit mësimor që ofron shkolla dhe i integron kërkësat e bazuara në planin e përmirësimit të proceseve mësimore në shkollë.

Nga ajo që vërejmë çdo ditë në shkollë tonë dhe të dhënat e mbledhura, themi se shkolla është me një performancë të shkëlqyer





**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



#### Vlerësimi i performancës për fushën e katërt - Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve

Faktor kyq për ngritjen e performancës së shkollës është edhe ngritja profesionale e mësimdhënësve, për këtë shkolla ka ofruar mundësi të shumta për trajnime të ndryshme duke filluar nga ato me bazë në shkollë, si dhe trajnime të tjera, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin profesional të mësimdhënësve i cili zhvillim reflekton në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies.

Në shkollën tonë përfshirja e mësimdhënësve në zhvillimin profesional bëhet:

- duke u bazuar në databazën e krijuar nga koordinatorët e shkollës përmes së cilës paraqitet një pasqyrë e qartë për nevojat e mësimdhënësve për ngritje profesionale;
- përmes hulumtimit individual të mësimdhënësve për zhvillim profesional;
- nga udhëheqësia e shkollës e cila e ka paraparë ngritjen profesionale të mësimdhënësve në PZSHH si dhe duke u bazuar në monitorimin e punës nëpër klasa bën orientimin e mësimdhënësve nëpër trajnimet e duhura.

Stafi drejtues mban përgjegjësi dhe angazhohet për trajnimet e mësimdhënësve të cilat ndikojnë në ngritjen e performancës së vet mësimdhënësit dhe në nivelin e mësimdhënies dhe nxënies. Bazuar në suksesin dhe mossuksesin e nxënësve mësimdhënësit vazhdimisht rishikojnë qasjen e tyre në mësimdhënie me qëllim që të përfshihen në zhvillimet e duhura profesionale.

Mësimdhënësit janë të vetëdijshëm për qëllimet dhe prioritetet e trajnimit dhe kualifikimit prandaj edhe i ndjekin ato dhe mundohen që arrijnë të përdoren në realizimin e mësimi të integruar. Aktivitetet profesionale hartojnë planet mujore duke respektuar korrelacionin mes lëndëve me qëllim të ngritjes së cilësisë në arsim. Vetvlerësimi i mësimdhënësve si dhe format e ndryshme të bashkëpunimit, ofrojnë nivel të lartë të mësimdhënies dhe nxënies.

Shkolla bashkëpunon me DKA-në, me OJQ që punojnë për ngritjen e cilësisë në arsim, me komunitetin dhe me donatorë të ndryshëm, me qëllim të sigurimit të mundësive të ndryshme për ngritje profesionale të mësimdhënësve.

Kushtet për trajnime në shkollë janë shumë të mira si në aspektin teknik, organizativ dhe të burimeve njerëzore. Shkolla ka koordinatorët për ZHPM të cilët hartojnë planin për mbajtjen e trajnimeve të nevojshme në shkollë, ka fasilitatorë të cilët ndihmojnë organizimin e trajnimeve me bazë në shkollë.

Bazuar në vëzhgimet e bëra, kemi vërejtur se mësimdhënësit përdorin teknika të ndryshme për punë, të cilat i kanë përfitur nga trajnimet e ndryshme që kanë ndjekur. Përmes monitorimeve sistematike shkolla merr informacione për nevojat e mësimdhënësve për ngritje profesionale dhe në bazë të ofertave që i ofrohen organizon trajnimet e nevojshme. Zhvillimi profesional është proces i vazhdueshëm ku gjithmone ka nevojë për përmirësim varesisht nga zhvillimit që ndodhin në arsim.

Përformancë e mirë

#### Vlerësimi i performancës për fushën e pestë - Performanca e nxënësve

Shkolla ofron mundësinë e përfshirjes së nxënësve duke ofruar një ambient të mirë dhe të sigurt. Nxënësit janë të përfshirë në të gjitha strukturat e shkollës duke filluar nga këshilli drejtues i shkollës, rinia shkollore, grupet e ndryshme punuese (grupi letrar, klubi i gjelbërt, klubi i matematicientëve, fizicientëve, ekipi i futbollit, basketbollit, volejbollit, etj). Në shumicën e këtyre grupeve vazhdimisht punohet duke marrë parasysh idetë si dhe mendimet e shumicës së nxënësve, me qëllim që vazhdimisht të kemi zhvillim të aftësive e shkathtësive të nxënësve (fizike e mendore), në mënyrë që ato të përdoren në situata të ndryshme për arrijnë e qëllimeve për zhvillimin dhe avancimin e nxënësve. Në vazhdimësi ekziston përkrahja, ndihma dhe motivimi nga mësimdhënësit e kjo ka treguar një ngritje në mësimdhënie, nxënie që ka ndikuar në ngritjen e performancës së nxënësve dhe ngritjen e performancës së shkollës. Duke ditur se bashkëpunimi në shumë raste ndikon në ngritjen e rezultateve edhe në rastin e mësimdhënies ka rëndësi të madhe, që të kemi një integrim të ngushtë, të aktiveve profesionale dhe atyre të klasëve. Shkolla tregon gatishmëri për bashkëpunim duke informuar nxënësit, mësimdhënësit me rregullat e shkollës, obligimet dhe përgjegjësitë. Nxënësit janë të përfshirë në strukturat që kanë hartuar këto rregulla. Nxënësit e gëzojnë autonominë për të propozuar dhe ndryshuar shumë çështje që janë për të mirën e tyre dhe shkollës. Ata i përdorin të gjitha hapësirat brenda dhe jashtë shkollës si dhe kanë mundësi që ato ti ndryshojnë apo edhe të shtojnë pjesë tjera. Nxënësit janë të përfshirë në një masë edhe në procesin e mësimdhënies duke marrë parasysh kërkesat e tyre për kohën e mbajtjes së testeve, mënyrën e realizimit të orëve mësimore, metodat e mësimdhënies, mënyrën e shfrytëzimit të kabineteve etj. Nxënësit e gëzojnë të drejtën për organizime të ndryshme ku në tërësi ata e planifikojnë atë projekt dhe vetë e realizojnë.



**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



Krahas përkushtimit për një përmbajtje brenda parimeve të parapara me kurrikulë rëndësi të madhe po i kushtohet zhvillimit të përgjegjësisë dhe llogaridhënies duke përgatitur nxënës me vetbesim, vizionarë, të përgjegjshëm dhe që jep llogari për punën e kryer.

Shkolla ka organizuar një mësimdhënie të integruar edhe për fëmijët me nevoja të veçanta dhe ka një infrastrukturë deri diku të përshtatshme për këta fëmijë. Ka ngecje në përgatitjen e hapësirave për lëvizjen e lirë të këtyre fëmijëve ku qasja e tyre në katet e sipërme është e pamundur. Ne aspektin financiar vlen të përmendet mos angazhimi i asistentëve nga institucionet që duhet të merren me këtë punë por e tëra mbulohet nga angazhimi dhe financimi i prindërve të tyre.

Shkolla krahas ekipeve të ndryshme punuese ka formuar edhe ekipin i cili merret me fëmijët të cilët bëjnë mungesa të paarsyeshme dhe është në bashkëpunim të përhershëm me menaxhmentin, prindërit dhe mësimdhënësit.

Performancë e shkëlqyer

Grupi i vlerësimit të performancës:

Isak Bregaj

Eliza Dibrani

Nazlije Cakolli

Arlinda Zeqiri

Shkurta Sylejmani

Nora Bajrami